**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER ALKET SKËNDAJ**

V20200539803960S7772

**DATE 28/10/2020**
**NR REP 6106**

## VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 28/10/2020, para meje Noterit ALKET SKËNDAJ, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Rr."Reshit ÇOLLAKU", Pall."SHALLVARE", Nr.09, Tirane., u paraqit personalisht:

**KËRKUES/IT:**
Emian Muçaj, atësia Ardian, amësia Vezire, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Mihal Grameno 78/6; Nd. 1 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 19/12/1989, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Leternjoftim ID nr. 033988209 dhe nr. personal I96219046W , .

AKT THEMELIMI date 26.10.2020, STATUT 26.10.2020 jane te njejta me mesazhin elektronik te ardhura nga adresa megi.alicka@al.gt.com ne adresen e noterit në emër të Shoqerise "GRANT THORNTON" SHPK.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.
Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.
Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**
ALKET SKËNDAJ

PULLE TARIFE
200 LEKE
R. SHQIPERISE

**AKTI I THEMELIMIT**

Në përputhje me ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" është vendosur:

## I. Themelimi

- EMËRTIMI I KOMPANISË: **ILIRIKE**

(individualisht "**Themeluesi**" )

Nëpërmjet kësaj deklaroj krijimin e **ILIRIKE** Shpk ("**Shoqërisë**"), sot më datë **26 tetor 2020** Shoqëri Shqiptare me Përgjegjësi të Kufizuar.

Adresa e Shoqërisë është: Rr. Sami Frashëri, Kompleksi T.I.D,Shk.B, Floor 1, 10,000, Tiranë, Shqipëri, zona kadestrale nr. 8160.

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar kohore, e cila fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

## II. Qëllimi dhe objekti

Objekti i aktiviteteve të Shoqërisë përfshin:

Konsulencë ndaj sektorit privat dhe publik. Shërbime marketing, komunikim, dhe marrëdhenie me publikun në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Konsulencë në krijimin dhe implementimin e strategjive dhe proçeseve inovative për përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve në sektorin privat dhe publik. Aktivitete kërkimore në fusha të ndryshme sipas metodave të shkencave sociale dhe humane. Hartim dhe menaxhim projektesh ndërkombëtare. Kryen aktivitet ne fushën e tregtisë; import eksport dhe tregti me pakicë i artikujve të ndryshëm industrial dhe ushqimorë. Aktivitete tregtare mund të kryhen direkt apo në formën e përfaqësive dhe/ose agjensive, si në Shqipëri dhe jashtë saj, përfshirë tregtinë me shumicë, pakicë dhe distribucione.

Në përputhje me Legjislacionin Shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i saj, Shoqëria mund:

i. të zotërojë aksione, pjesëmarrje në shoqëri që kanë një qëllim të ngjashëm, të lidhur me qëllimin ose madje edhe të ndryshëm nga qëllimi;

ii. Të kryejë ndërmjetësime, negocime, agjencinë, përsa i përket blerjeve dhe shitjeve, veprimtarive të importit dhe eksportit në përgjithësi;

iii. Të kryejë cdo transaksion të lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si edhe cdo veprimtari tregtare, financiare, qiradhënëse, të lënies peng të hipotekës apo pengjeve, e cila mund të konsiderohet e nevojshme ose e dobishme për të arritur qëllimin e Shoqërisë, me kusht që këto veprimtari nuk kryhen për një qëllim më të madh që i kalon qëllimet e përmendura sa më sipër;

- Shoqëria mund të kryejë aktivitete që nuk janë në objektivin e saj, që e favorizon atë.
- Shoqëria duhet të respektojë të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi.

### III. Statuti i Shoqërisë

Ortakët themelues deklarojnë miratimin e Statutit të Shoqërisë.

### IV. Kapitali

Kapitali i Shoqërisë është 100 Lek (Lekë shqiptar).

Themeluesit e Shoqërisë dhe Pjesët e Kapitalit përkatëse të tyre, janë si më poshtë:

(i) Zj. Suela Llaci, shtetase shqiptar, lindur më 17/08/1976, në Fier, Shqipëri me nr. e kartës së identitetit H65817051O, zotëruese 100 % e kapitalit, në vlerën 100.00 Lek i barabartë me 1 kuotë;

Secila prej Kuotave i jep të drejtën e një vote mbajtësit të saj. Pronësia e kuotave është paraqitur në Librin e Shoqërisë.

Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe papaguar nga Ortakët Themelues.

### V. Bordi i Administratorëve

Bordi i Amdinistratorëve përbëhet nga një anëtar Zj. Suela Llaci e cila do të jetë përgjegjëse për çështjet e Shoqërisë, u nënshtrohet kufizimeve që vijnë nga Statuti i Shoqërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Administratori i parë dhe i vetëm i Shoqërisë është:

1. Zj. Suela Llaci, shtetase shqiptar, lindur më 17/08/1976, në Fier, Shqipëri me nr. e kartës së identitetit H65817051O.

Administratori emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjecare. Administratorët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme me vendim të zakonshëm. Asambleja e Përgjithshme ka fuqinë të anullojë me vendim të zakonshëm emërimin e ndonjë ose të gjithë administratorëve, për cfarëdolloj arsye.
Nëse nuk vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme, Administratorët do të veprojnë për ndonjë cështje që nuk i përkasin autoritetit të Ortakëve në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe kufizimet e të drejtave që i'u janë dhënë, dhe të gjitha vendimet e ardhshme të Ortakëve dhe me legjislacionin në fuqi.

### VII. Autorizime

Aksionerët Themelues autorizojnë **Grant Thornton Shpk**, Shoqëri me pergjegjësi të kufizuar me **NIPT K91923007M,** të nënshkruajë, kryejë dhe të paraqesë në emër të Shoqërisë të gjitha dokumentat e nevojshme për të përfunduar dhe bërë efektiv rregjistrimin e ILIRIKE Shpk, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në plotësimin dhe nënshkrimin e Formularit të Aplikimit dhe dorëzimin e dokumentave të kërkuara nga autoritetet kompetente.

*Ky Akt Themelimi u hartua në 3 (tre) kopje origjinale që kanë efekte ligjore të barabarta. Akti i Themelimit është në përputhje me Legjislacionin Shqiptar. Akti i Themelimit u lexua në prani të Ortakëve Themelues, u kuptua drejtë, në përputhje me vullnetin e lirë dhe të plotë, dhe u nënshkrua përpara meje dhe unë këtu vërtetoj se ai është në përputhje me legjislacionin.*

**ORTAKËT THEMELUES**

Suela Llaci

**Tirane me 26 tetor 2020**

**STATUTI I SHOQERISE**
**"ILIRIKE" Sh.p.k.**

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne te nenshkruarit shpallim si me poshte vijon:

**FORMIMI I SHOQERISE**
**Neni 1**

Sot me date 26.10.2020 formohet Shoqeria e quajtur **"ILIRIKE" Sh.p.k.** (qe me poshte do te quhet "Shoqeria") me ortakë:

1. Zj. Suela Llaci, shtetase shqiptar, lindur më 17/08/1976, në Fier, Shqipëri me nr. e kartës së identitetit 032011843 dhe me numer personal H65817051O, zotëruese 100 % e kapitalit, në vlerën 100.00 Lek i barabartë me 1 kuotë;

**Forma ligjore e Kompanise**
**Neni 2**

2.1. Shoqëria është një person juridik shqiptar, ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, sipas **dispozitave te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqerite Tregtare" ("Ligji i Shoqerive").**

**SELIA E SHOQERISE**
**Neni 3**

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rr. Sami Frashëri, Kompleksi T.I.D, Shk.B, Kati 1, 10,000, Tiranë, Shqipëri, zona kadestrale nr. 8160.
Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra perfaqësimi kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE**
**Neni 4**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë eshte për një periudhe të pakufizuar kohore, e cila fillon që prej dates së regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

## KAPITULLI II
## Objektivat e Shoqerisë

### Neni 5
### Objektivat e Shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Konsulencë ndaj sektorit privat dhe publik. Shërbime marketing, komunikim, dhe marrëdhenie me publikun në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Konsulencë në krijimin dhe implementimin e strategjive dhe proçeseve inovative për përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve në sektorin privat dhe publik. Aktivitete kërkimore në fusha të ndryshme sipas metodave të shkencave sociale dhe humane. Hartim dhe menaxhim projektesh ndërkombëtare. Kryen aktivitet ne fushën e tregtisë; import eksport dhe tregti me pakicë i artikujve të ndryshëm industrial dhe ushqimorë. Aktivitete tregtare mund të kryhen direkt apo në formën e përfaqësive dhe/ose agjensive, si në Shqipëri dhe jashtë saj, përfshirë tregtinë me shumicë, pakicë dhe distribucione.

Në përputhje me Legjislacionin Shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i saj, Shoqëria mund:

i) të zotërojë aksione, pjesëmarrje në shoqëri që kanë një qëllim të ngjashëm, të lidhur me qëllimin ose madje edhe të ndryshëm nga qëllimi;

(ii) Të kryejë ndërmjetësime, negocime, agjencinë, përsa i përket blerjeve dhe shitjeve, veprimtarive të importit dhe eksportit në përgjithësi;

(iii) Të kryejë cdo transaksion të lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si edhe cdo veprimtari tregtare, financiare, qiradhënëse, të lënies peng të hipotekës apo pengjeve, e cila mund të konsiderohet e nevojshme ose e dobishme për të arritur qëllimin e Shoqërisë, me kusht që këto veprimtari nuk kryhen për një qëllim më të madh që i kalon qëllimet e përmendura sa më sipër;

- Shoqëria mund të kryejë aktivitete që nuk janë në objektivin e saj, që e favorizon atë.
- Shoqëria duhet të respektojë të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi.

### Neni 6

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emertimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.

## Kapitulli III
## Kapitali, pjesët e Kapitalit dhe Ortakët
## Neni 7

- Kapitali i Shoqërisë është 100 Lek (Lekë shqiptar).

- Themeluesit e Shoqërisë dhe Pjesët e Kapitalit përkatëse të tyre, janë si më poshtë:

- Zj. Suela Llaci, shtetase shqiptar, lindur më 17/08/1976, në Fier, Shqipëri me nr. e kartës së identitetit 032011843, zotëruese 100 % e kapitalit, në vlerën 100.00 Lek i barabartë me 1 kuotë;

## Neni 8
## Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

8.1. Kapitali mund te zmadhohet ose te zvogelohet ne perputhje me vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV ketu dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te Shoqerive.

8.2. Kapitali do te zmadhohet me ane te kontributit ne para ose ne natyre, si dhe do te perfshije rezervat ose fitimet ose kalimit te borxheve ne kapital,

8.3. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te emetimit te kuotave te reja ose duke rritur vleren e kuotave ekzistuese. Kuotat do te nenshkruhen dhe vlera e tyre do te paguhet plotesisht.

8.4. Shoqeria nuk mund te bleje asnje Kuote te Kapitalit te saj. Megjithate per qellime te zvogelimit te kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit te zvogelimit te kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin/Administratoret te bejne blerjen e Kuotave perkatese dhe t'i anullojne ato me pas.

## Neni 9
## Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

9.1. Ortaket e Shoqerise jane vetem ata qe zoterojne Kuotat e Shoqerise;
9.2. Secila Kuote jep te drejten e nje vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve (Asambleja e Pergjithshme), e drejta per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, si dhe te drejta te tjera qe sigurohen ne perputhje me Statutin aktual te Shoqerise, dhe me dispozitat satutore te Ligjit te Shoqerive.

9.3. Ortaket kane te drejten, me ane te kerkeses me shkrim, te marrin informacione dhe te dhena per aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, perfshire ketu te drejten per te kontrolluar rregjistrimet dhe dokumentacionin e Shoqerise,
9.4. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i Kuotave i transferohen zoteruesve te rinj te ketyre kuotave.
9.5. Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nepermjet kapitalit te saj. Ortaket nuk kane asnje detyrim ne tejkalimin e pjeses se tyre te papaguar ne investimin e kapitalit te Shoqerise (pervec garancive dhe kredive qe ata bejne).
9.6. Shoqeria nuk mund te mbaje asnje detyrim per borxhet ose detyrime personale te tjera te Ortakeve te tyre.

## Neni 10
## Transferimi i Pjeseve te Kapitalit

10.1. Transferimi inter vivo ose mortis causa i Kuotave te Shoqerise tek Pale te treta i nenshtrohet te drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere mbi bazen e modaliteteve te detajuara ne nenet e rneposhtme.

10.2. Ne rast se nje Ortak ("Ofertues") kerkon te shese dhe/ose te transferoje ndonje ose te gjitha Kuotat, Ortaku i mbetur ("Ortaku i Mbetur") gezon te drejten e refuzimit te Kuotave te cilat jane propozuar per tu transferuar ("Kuotat e Ofruara"), subjekt i termave dhe kushteve te meposhtme:

(a) Ofertuesi duhet fillimisht te nise tek Ortaku i Mbetur nje njoftim me shkrim duke detajuar numrin e Kuotave te Ofruara, si dhe cmimin e Kuotave te Ofertuara dhe detajet e pales se trete dhe termat e tjera materiale te transferimit **("Ofertuesi")**, duke ftuar fillimisht Ortakun e mbetur per blerjen e Kuotave te Ofruara;
(b) Ortaku i Mbetur ka te drejte, ne baze propocionale, te bleje Kuotat e ofruara sipas termave te Ofertuesit duke derguar nje njoftim me shkrim tek Ofertuesi brenda nje periudhe 45 (dyzetë e pese) ditore pas marrjes se njoftimit te Ofertes.

10.3. Ne rast se Ortaku i Mbetur ka vendosur te marre Kuotat e Ofertuara, kjo transferte do te ndodhe, sipas kushteve te Ofertuesit, ne menyren e percaktuar ketu.

10.4 Ne rast se Ortaku i Mbetur ka refuzuar te bleje keto Kuota te Ofertuara, ne menyren e percaktuar ketu, para se ofertuesi ka te drejte te transferoje kuotave e marra nje pale te trete (ne pajtim me kushtet e ofertes fillestare), pjesa e mbetur e partnerve ka te drejte te shprehe miratimin e tij për partnerin ne hyrje, brenda 30 (tridhjete) ditesh. Ne rast se Partneri në hyrje nuk eshte miratuar, Partneri i mbetur do te bleje kuotat e ofruara (ne perputhje me kushtet e ofertes fillestare)

10.5. Asnje prej Ortakeve nuk ka te drejte te transferoje ceshtjet e parashtruara me siper tek ndonje prej Shoqerive e cila eshte nen kontrollin e ketij Ortaku.

10.6. E drejta e parablerjes në favor të partnëreve të tjerë vlen edhe për transferimin e kuotave të kompanise pa percaktimin e cmimit të kuotave të ofruara. Në këtë rast cmimi përcaktohet nga Partnerët me marrëveshje të përbashkët ose nga vlerësimi i pergatitur nga një ekspert i identifikuar me marrëveshje të përbashkët ose, në rast se marreveshja nuk është arritur, eksperti është caktuar nga arbitrazhi.

10.7. Të gjitha komunikatat e parashikuara në këtë nen duhet t'i drejtohen Shoqërisë.
10.8. Cdo transferim i të drejtës së pronësisë së aksioneve, si dhe krijimi ose transferimi i ndonjë të drejte duhet të regjistrohet në regjistrin e ortakëve,

## KAPITULLI IV
## Asambleja e Pergjithshme

### Neni 11
### Rregulla te pergjithshme

11.1. Bordi vendimmarres i Shoqerise eshte Mbledhja e Pergjithshme e cila perbehet nga te gjithe Ortaket e Shoqerise.
11.2. Secilit Ortak i lind e drejta per te marre pjese ne Mbledhjen e Pergjithshme, qe te shprehe opinionin e tij dhe ndikoje me aq vota sa Kuota ka.
11.3. Secilit Ortak i lind e drejta te perfaqesohet nga nje person tjeter, jo domosdosmerisht Ortak, me ane te nje prokure. Ne rast te dhenies se nje prokure per pjesemarrje ne Mbledhjen e pergjithshme, kjo eshte e vlefshme vetem per thirrjen e tij te pare dhe te dyte.
11.4.Mbledhja e Pergjithshme mund te mbahet ne nje vend te ndryshern nga zyra qendrore, brenda Republikes se Shqiperise ose Italise ose jashte saj.
11.5. Mbledhja e Ortakeve thirret nga Administratoret aq here sa shihet e nevojshme nga legjislacioni ne fuqi apo interesat e Shoqerise apo nga kerkesat e Ortakeve qe zoterojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit.
Megjithate, Mbledhja e Pergjithshme duhet te mbahet te pakten njehere, brenda muajit Mars te cdo viti, per qellime diskutimi, shqyrtimi dhe aprovimi te pasqyrave vjetore te vitit te meparshern financiar.
11.6. Mbledhja e Pergjithshme duhet te thirret te pakten 7 (shtate) dite perpara mbajtjes se takimit nepermjet:
• Nje poste elektronike e certifikuar (PEC os ekuivalente) te derguar nepermjet postes elektronike te Ortakut te percakruar ne regjistrin e Ortakeve;
• Nje korrespondence te dhene dorazi te nenshkruar nga Ortaket per marrjen e saj;
• Cdo mjeti tjeter te pershtatshern i cili mund te vertetoje marrjen e saj.

11.7. Njoftimi duhet te permbaje ceshtjet qe do diskutohen dhe qe do te zgjidhen, vendin, oren dhe daten, procedurat e hollesishme te pjesemarrjes ne takim dhe te votimit, informacione per vendin dhe modalitetet per te marre dokumentat dhe projekt-vendimet e mbledhjes dhe elementeve te tjere te percaktuara me ligj.
11.8. Mbledhja e Pergjithshme do te konsiderohet e vlefshme edhe nese te gjitha formalitetet nuk jane realizuar per thirrjene saj, me kusht qe i gjithe kapitali te jete i pranishern ose i perfaqesuar me prokure, ne perputhje me ligjin ne fuqi dhe te gjithe ortaket e pranishem apo te perfaqesuar ne asamble te jene dakord per te vazhduar me takimin, pavaresisht parregullsive te thirrjeve.
11.9. Mbledhja e Pergjithshme mund te mbahet nepermjet pjesemarrjes se Ortakeve ne vende te ndryshme dhe kjo mund te behet nepermjet telekonferences ose video konferences, ose me mjete te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjithe pjesemarresit te jene identifikuar dhe tu jete dhene mundesia te ndjekin diskutimin dhe te marrin pjese ne mbledhje. Per me teper, vendimet e Asamblese se Pergjithshme mund te miratohen edhe nepermjet qarkullimit te materialeve me shkrim, pa e mbajtur apo thirrur mbledhjen me kusht qe te nenshkruhet nga te gjithe Ortaket brenda 30 (tridhjete) diteve.

11.10. Mbledhja e Pergjithshme drejtohet nga kryetari i emeruar nga Ortaket e pranishem ne mbledhje me shumice te zakonshme. Nese nuk parashikohet prania e nje noteri, Mbledhja e Pergjithshme cakton nje sekretar, i cili jo domosdoshmerisht duhet te jete ortak. Kryetari dhe sekretari, nese emerohen, duhet te jene te pranishem ne te njejtin vend ku mbahet mbledhja.
11.11. Kryetari i mbledhjes ka pushtet te plote te verifikoje prokurat dhe vertetesine e tyre, te drejtat e Ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Mbledhjen e Pergjithshme, dhe të vendosë nese kjo e fundit eshte mbajtur rregullisht dhe nese eshte arritur kuorumi i Ortakeve per te miratuar vendime te vlefshme. Kryetari ka gjithashtu te drejte te kryesoje diskutimet dhe te vendose menyrat dhe procedurat perkatese te votimit.
11.12. Mbledhja e Pergjithshme do te mbahet ne gjuhen Angleze ose Italiane dhe cdo material me shkrim i diskutuar ne Mbledhjen e Pergjithshme do te mbahet ne gjuhen Angleze ose Italiane. Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesemarresve ne mbledhje do te pergatitet menjehere pas cdo mbledhje, dhe do te nenshkruhet nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes, dhe noteri nese kerkohet, Nese vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesemarresve ose dokumentave te tjera perkatese kerkohen ne gjuhen Shqipe, do te sigurohet perkthimi i tyre ne gjuhen Angleze dhe Italiane.
11.13. Ne rast se Shoqeria ka vetem nje Ortak qe mban gjithe kapitalin e Shoqerise, vendimet e miratuara duhet te hidhen ne rregjistrin e vendimeve, te dhenat ose rregjistrimi i tyre nuk mund te ndryshohet ose te fshihet.

## Neni 12
## Kompetencat

12.1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise.
12.2. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ceshtjet e meposhtme:

- Ndryshime ne Statutin e Shoqerise;
- Emerimin dhe shkarkimin e administratorit/ve;
- Emerimin dhe shkarkimin e Auditoreve dhe Likuiditoreve;
- Shperblimin e Administratoreve, Auditoreve dhe Likuiditoreve;
- Kontrollin dhe mbikqyrjen e zbatimit te politikave te biznesit nga administratoret, duke perfshire pergatijen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportin e performances;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportin e performances;
- Shperndarjen e fitimeve vjetore;
- Rritjen dhe zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;
- Ndarjen e Kuotave ne pjese dhe anullimi i Kuotave;
- Ristrukturimin dhe mbylljen e Shoqerise;
- Zbatimin e rregullave dhe procedurave ne lidhje me Mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme;
- Përshtatjen e rregullave dhe procedurave në lidhje më mbledhjet e Asamblesë së Përgjithëshme.

Te gjitha vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te rregjistrohen dhe te depozitohen ne Librin e Shoqerise (Rregjistri).

## Neni 13
## Kuorumi dhe Shumica

13.1. Ne rast te marrjes se vendimeve te jashtezakonshme, Mbledhja e Pergjithshme mund te miratoje vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem, Ortaket qe zoterojne mbi 75% (shtatedhjete e pse perqind) te te drejtave te votes. Nese Mbledhja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet ne thirrjen e pare per shkak te mungeses se Kuorumit, mbledhja duhet te rithirret me te njejtin rend dite jo me vone se 30 (tridhjete) dite nga mbledhja e pare. Ne rast te marrjes se vendimeve te jashtezakonshme, kjo e fundit miratohet me te pakten 75 % (shtatedhjete e pese perqind) te votave te Shoqerise.

13.2. Mbledhja e Pergjithshme mund te miratoje vendime te jashtezakoshme ne ceshtjet e meposhtme:

- ndryshime ose shtesa ne Statutin e Shoqerise;
- rritje ose zvogelim i kapitalit;
- shperndarja e fitimeve vjetore;
- ristrukturim, shperberja, transformimi, bashkimi, shkrirja, ndarja ose likuidimi i Shoqerise apo
- riorganizimi i Shoqerise ne nje forme tjeter te korporates.

Ne rast te vendimeve te zakonshme, Mbledhja e Pergjithshme mund te miratoje vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem Ortaket qe zoterojne me shume se 75% (shtatedhjete e pese perqind) te te drejtave te votes. Nese Mbledhja e Pergjithshrne nuk mund te mbahet per shkak te mungeses se kuorumit ne thirrjen e pare, mbledhja mund te mbahet me te njejtin rend dite jo me vone se 30 (tridhjete) dite nga mbledhja e pare. Ne rast te marrjes se vendimeve te zakonshme, kjo e fundit miratohet me 75% (shtatedhjete e pese perqind) te votave te Shoqerise.

13.4. Mbledhja e Pergjithshme mund te miratoje vendime per ceshtje te zakonshme te cilat nuk jane listuar ne nenin 13.2 me lart.

# KAPITULL IV
# Bordi i Administratoreve

## Neni 14
## Bordi i Administratoreve

14.1. Shoqeria menaxhohet ne menyre alternative nga Administratori i Vetem ose Bordi i Administratoreve i perbere nga dy ose me shume anetare te cilet do te jene pergjegjes per ceshtjet e Shoqerise, te cilat u nenshtrohen kufizimeve qe vijne nga Statuti i Shoqerise dhe legjislacioni ne fuqi.

14.2. Administratoret e pare dhe i vetmi i Shoqerise eshte:

2. Zj. Suela Llaci, shtetase shqiptar, lindur më 17/08/1976, në Fier, Shqipëri me nr. e kartës së identitetit 032011843 dhe me numer personal H65817051O.

Administratori emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjecare. Administratorët emërohen nga

Asambleja e Përgjithshme me vendim të zakonshëm. Asambleja e Përgjithshme ka fuqinë të anullojë me vendim të zakonshëm emërimin e ndonjë ose të gjithë administratorëve, për çfarëdolloj arsye.

14.4. Administratoret emerohen nga Asambleja e Pergjirhshme me vendim te zakonshem, Pas pranimit te emerimit te tyre, Administratoret duhet te pranojne se marredhenia e tyre me Shoqerine eshte mbi nje baze mirebesimi, Asambleja e Pergjithshme ka fuqine te anulloje me vendim te zakonshem emerimin e njerit ose te te gjithe administratoreve, per cfaredolloj arsye.

14.5. Nese Ortaket nuk e kane percaktuar ne kohen e emerimit, Bordi i Administratoreve ben zgjedhjen e Kryetarit nga radhet e anetareve te tij.

**Neni 15**
**Mbledhjet e Bordit te Administratoreve**

15.1. Nese kerkohet nga Administratori dhe ne rastet e percaktuara me ligj, Bordi i administratoreve duhet te diskutoje dhe te vendose per mbajtjen e mbledhjes se bordit.

15.2. Ne kete rast, kryetari therret Bordin e Administratoreve, deklaron agjenden, koordinon punen dhe aktet ne menyre qe te gjithe Administratoret te informohen ne menyren e duhur per ceshtjet qe do te diskutohen.

15.3. Mbledhja e Bordit te administratoreve mund te mbahet edhe ne nje adrese tjeter dhe jo vetem ne seline brenda Republikes se Shqiperise, Italise, apo jashte shtetit.

15.4. Mbledhja e Bordit te administratoreve duhet te thirret te pakten 3 (tre) dire para, dhe ne rast te urgjence, te pakten 1 (nje) dite para dites se caktuar per mbledhjen, permes:

- Nje poste elektronike e certifikuar te derguar nepermjet postes elektronike te Administratoreve te Shoqerise;
- Nje korrespondence te dhene dorazi te nenshkruar nga Administratoret per marrjen e saj;
- Cdo mjeti tjeter te pershtatshem i cili mund te vertetoje marrjen e saj.

15.5. Njoftimi duhet te permbaje temat qe do te diskutohen dhe te caktoje vendin, kohen dhe daten, procedurat e hollesishme te pjesemarrjes dhe te votimit ne mbledhje, informacion mbi vendin dhe modalitetet per te marre dokumentacionin dhe projekt vendimet e takimit dhe elemente te tjera te percaktuara sipas legjislacionit ne fuqi.

15.6. Mbledhja e Bordit te Administratoreve do te konsiderohet e vlefshme edhe nese nuk jane kryer te gjitha formalitetet qe rregullojne thirrjet per mbledhje, me kusht qe te gjitha Administratoret te jene te pranishem dhe te bien dakord per te vazhduar me takimin, pavaresisht nga parregullsite e thirrjeve.

15.7. Mbledhja e Bordit te Administratoreve mund te mbahet nepermjet pjesemarrjes se Administratoreve ne vende te ndryshme, dhe kjo mund te behet edhe nepermjet telekonferences apo videokonferences, ose me mjete te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjithe pjesemarresit te jene identifikuar, tu jete dhene mundesia per te ndjekur diskutimin dhe per te marre pjese ne menyre aktive ne te, Per me teper, vendimet e Bordit i Administratoreve mund te miratohen edhe nepermjet qarkullimit te materialeve me shkrim, pa thirrur ose mbajtur mbledhjen, me kusht qe te nenshkruhet nga te gjithe Administratoret brenda 30 tridhjete) ditesh.

15.8. Mbledhja e Bordit te Administratoreve kryesohet nga Kryetari i Bordit te Act~stratoreve apo nga Administratore te tjere te emeruar ne mesin e administratoreve te pranishem n~Jkim me shumice te zakonshme. Nese 'nuk parashikohet prania e nje noteri, Mbledhja e Bordit te Admistratoreve emeron nje sekretar, i cili jo domosdoshmerisht duhet te jete nje Administrator. Kryetari dhe sekretari, nese emerohen, duhet te jene te pranishem ne te njejtin vend ku mbahet mbledhja.

15.9. Mbledhja e Bordit te Administratoreve do te mbahet ne gjuhen italiane dhe angleze apo dhe cdo material me shkrim i diskutuar ne mbledhjen e Bordit te Administratoreve do te jete ne anglisht ose italisht. Vendimet, Procesverbalet dhe lista e pjesemarresve ne mbledhje do te pergatitet menjehere pas cdo mbledhjeje, dhe do te nenshkruhet nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes, dhe noteri, nese kerkohet, Nese vendimet, Procesverbali dhe lista e pjesemarresve ne mbledhje ose e dokumenteve te tjera te ngjashme duhet te jene ne gjuhen shqipe, atehere do te sigurohet perkthimi ne anglisht ose italisht.
15.10. Vlefshmeria e vendimeve te Bordit te Administratoreve te miratuara nga Mbledhja e Bordit, kerkon pranine aktuale te shumices se anetareve te tij ne detyre; vendimet merren me shumicen absolute te votave te administratoreve aktuale.

## Neni 16
## Kompetencat e Bordit te Administratoreve

16.1.Administratori i vetëm ose bordi i Administratorëve ka te gjitha kompetencat per drejtimin e kompanise, përvec aktiviteteve të mëposhtme, të cilat kërkojne një aprovim më përpara nga ortakët:

- Blerjen dhe tranferimin e pasurive të patundshme dhe krijimin, modifikimin, ose fshirjen e të drejtave ndaj pasurive të paluajtshme;
- Shitjen ose dhënien me qera të një ose më shumë divisoneve ose biznese të kompanise palëve të treta;
- Krijimi i Shoqërive, consortium ose entitete kolektive, përfshirë sipërmarrjet e përbashkëta;
- Blerjen ose shitjen e aksioneve të Shoqërisë.

Të tjera kufuzime të fuqisë së administratorit ose bordit të administratorëve, përvec të listuarave më sipër, mund te vendosen në kohën e emërimit të administratorit/ administratorëve.

16.2. Ne rastin e nje Bordi Administratoresh te perbere nga dy anetare, kurdo qe administratoret nuk pajtohen me revokimin eventual te nje prej administratoreve, te dy anetaret e bordit shkarkohen dhe duhet te paraqesin propozimin per emerimin e Bordit te ri te administratoreve nepermjet nje vendimi Ortakesh brenda 30 (tridhjete) ditesh.

## Neni 17
## Perfaqesimi

17.1. Administratori i Vetem perfaqeson Shoqerine,
17.2. Nese emerohet Bordi i Administratoreve, perfaqesimi i kompanise i caktohet Kryetarit te Bordit te Administratoreve dhe Administratoreve Menaxhues, nese eshte emeruar.

**KAPITULLI VI**
**Administrimi financiar i Shoqerise**

**Neni 18**
**Kontabilist i Miratuar Publik**

18.1. Asambleja e Pergjithshme mund te caktoje numrin e Kontabilisteve te miratuar publik ("KM") dhe afatin kohor te percaktuar nga Ligji Shqiptar.
18.2. KM duhet te kryeje funksionin e audituesit ne perputhje me Ligjin Shqiptar.

**KAPITULLI VII**
**Aktiviteti financiar**

**Neni 19**
**Viti financiar**

19.1. Viti fiskal filion ne daten e pare te muajit Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Megjithate, viti i pare financiar dhe fiskal filion ne daten e themelimit te Shoqerise.

**Neni 20**
**Mbajtja e kontabilitetit**

20.1.Shoqeria do te mbaje kontabilitetin ne monedhen Lek Shqiptar dhe ne monedhe te huaj për qëllime të raportimit të brendshëm.

**Neni 21**
**Llogaritja e fitimit dhe shperndarja**

21.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar ngai\sambleja e Pergjithshme. Shperndarja do te percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin e Shoqerise, dhe legjislacionin ne fuqi.
21.2. Nga fitimi vjetor, krijohet nje fond rezerve sipas percaktimeve nga ligji Shqiptar per fondet rezerve te detyrueshme.

**KAPITULLI VIII**
**Te ndryshme**

**Neni 22**
**Legjislacioni ne fuqi**

22.1. Kjo Marreveshje do te udhehiqet dhe do te interpretohet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.

**Neni 23**
**Arbitrazhi**

23.1.Palet pranojne qe te dorezojne te gjitha mosmarreveshjet qe lindin nga vlefshmeria, interpretimi a performanca e Statutit.
23.2. Te gjitha mosmarreveshjet e lindura nga dhe ne lidhje me Marreveshjen aktuale do te zgjidhen perfundimisht sipas Rregullave te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

**Neni 24**
**Gjuha**

24.1 Statuti i Shoqerise eshte perpiluar ne 3 (tre) kopje ne Shqip dhe ne Anglisht. Per cdo kundershtim qe del nga zbatimi dhe/ ose interpretimi i keti] Statuti te Shoqerise, versioni Anglisht do te sundoje i cili do te kete efekte ligjore.

**Neni 25**
**Dispozita perfundimtare**

25.1 Per cdo ceshtje qe nuk rregullohet ne menyre specifike nga Statuti i Shoqerise do te aplikohet Ligji Shqiptar mbi Shoqerite.

**Nenshkrimet**

**Ortaket themelues**

Suela Llaci

**Tirane 26 tetor 2020**